



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Këshilli i Ministrave**

**URDHËR**

**Nr. 203, datë 19.12.2005**

**PËR**

**MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË NJËSISË ANTITRAFIK**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102 të Kushtetutës,

**U R D H Ë R O J:**

1. Njësia Antitrafik funksionon pranë Ministrisë së Brendshme, sipas strukturës organizative të miratuar të kësaj ministrie.
2. Njësia e Antitrafik drejtohet nga zëvendësministri i Brendshëm, për çështje të luftës kundër trafikut, dhe ka këto detyra:
  - a) Monitoron veprimtarinë e institucioneve të ngarkuara për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore;
  - b) Bashkërendon punën me këto institucione në zbatim të detyrave të ngarkuara nga Strategjia Kombëtare e Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore;
  - c) Mbledh, nga institucionet e përfshira në strategji dhe nga burime të tjera publike, të dhëna për çështje të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe i përpunon ato;
  - ç) Administron bazën e të dhënave të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe i paraqet raporte përmbledhëse për këtë

çështje Komitetit Shtetëror (ndërministror) të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore. Këto raporte janë publike për të tretë, sipas ligjeve nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, dhe nr. 8517, datë 22.07.1999, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

- d) Propozon ndryshime dhe përmirësime në sistemet dhe mekanizmat e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore;
  - dh) Nxit rritjen e transparencës së veprimtarisë së institucioneve shtetërore, të përfshira në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore, me synim ndërgjegjësimin në këtë fushë, duke bashkëpunuar me institucionet e tjera dhe shoqërinë civile për këto çështje.
3. Njësia Antitrafik kryen rolin e Sekretariatit Teknik të Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore.
4. Të gjitha ministritë dhe institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave, që zbatojnë ose kryejnë detyra, sipas planveprimeve, në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore ngarkohen që, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të caktojnë një nëpunës, të nivelit të lartë, si përgjegjës për bashkëveprimin me Njësinë Antitrafik, në Ministrinë e Brendshme.

Ky person ka këto përgjegjësi konkrete:

- a) Është personi i kontakti të institucionit me Njësinë Antitrafik, në ministrinë e Brendshme;
- b) Është personi përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin në këtë institucion të detyrave të parashikuara nga plani i veprimeve, në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore.

Ftohen edhe institucionet e pavarura dhe institucione të tjera, të përfshira në strategji, të paraqesin në këtë njësi emrin e nëpunësit përgjegjës.

5. Ministritë dhe institucionet e përcaktuara në pikën 4, të këtij urdhri, i paraqesin, çdo tre muaj ose sipas kërkesës së tij, zëvendësministrit të Brendshëm për çështje të luftës kundër trafikut, një raport përmbledhës për realizimet, në kuadër të planit të veprimeve dhe treguesve statistikorë,

si dhe të detyrave të caktuara nga Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore.

Ftohen edhe institucionet e pavarura dhe institucione të tjera, të përfshira në strategji, të paraqesin të tilla raporte.

6. Ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm, për çështje të luftës së trafikut të bashkërendojë punën dhe mbikëqyrë zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**

**SALI BERISHA**